REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KUKËS

Nr. 32/17 Prot. Kukës, më 18.06.2026

VENDIM

Nr. 02 datë 18/06/2026

PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028 NË NIVEL PROGRAMI

Në zbatim të udhëzimit nr. 8 datë 28.02.2025 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028", udhëzimit nr. 7 datë 25.2.2022 "Për një ndryshim të udhëzimit nr. 23 datë 30.7.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Vendimi i Keshillit te Qarkut Kukes nr. 13 datë 13.12.2024 "Për miratimin e kalendarit të PBA 2026- 2028 dhe Vendimi i Keshillit te Qarkut Kukes nr. 12 datë 13.12.2024 "Per miratimin e buxhetit vjetor 2025". Këshillit të Qarkut Kukës në mbledhjen e tij të datës së mësipërme:

VENDOSI:

1. Të miratojë tavanet përgatitore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 sipas tabelave bashkangjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Zhvillimit Rajonal si dhe Drejtoria Juridike. MBNJ dhe Shërbimeve mbështetëse.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
ASTRIT DOBRUSHI

Miratuar me : 9 vota
Pro: 9
Kunder: 0
Abstenim: 0
Zbardhur me: 18.06.2026